| | |
|---|---|
| **Buletini Nr. 348/ 2022, 14-12-2022** | **Parashikimi** nga 14-12-2022, ora 12:00 deri më 15-12-2022, ora 23:59. |

## PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PERMBYTJET

Sipas llogaritjeve hidrologjike të IGJEO, gjatë ditës së sotme dt.14 Dhjetor dhe gjatë ditës së nesërme dt.15 Dhjetor si rezultat i reshjeve me intensitet të lartë do të ketë rritje të rrezikshme të prurjeve në lumenjtë e mëdhenj dhe të mesëm Drin-Buna, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë. Përmbytje mund të shkaktohen nga lumi Drin-Buna dhe Liqeni i Shkodrës me prurje maksimale të cilat parashikohen të arrijnë zonat e rrezikuara gjatë paradites së ditës së nesërme, dt.15 Dhjetor. Lumenjtë Mat, Ishëm, Erzen dhe Shkumbin do i arrijnë prurjet maksimale gjatë pasdites së nesërme, dt.15 Dhjetor. Në lumenjtë Seman dhe Vjosë nuk pritet rrezik për përmbytje.

Në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastër pritet të ketë vërshime të shpejta të lumenjve si dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane të këtyre qarqeve pritet të ketë përmbytje të lokalizuara në varësi të gjendjes së kanalizimeve. Ky informacion do të përditësohet nga IGJEO sipas llogaritjeve më të fundit hidrologjike dhe do të njoftoheni për çdo ndryshim në parashikimin e përmbytjeve.

## PARASHIKIMI METEO

**-------------------------**

### RESHJET

Sot pasdite (e mërkurë, dt.14) dhe nesër (e enjte, dt.15) priten reshje shumë intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë dhe Elbasan. Gjithashtu priten reshje intensive në qarqet Durrës, Tiranë, Vlorë dhe Gjirokastër si dhe reshje mesatare në qarqet Fier, Berat dhe Korçë. Reshjet pritet të shoqërohen dhe me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

### TEMPERATURAT

Nesër (e enjte, dt.15) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet: 15 / 19 °C, në vendet e ulëta: 14 / 19 °C, në vendet malore: 7 / 15 °C

### ERA

Sot pasdite (e mërkurë, dt.14) dhe nesër (e enjte, dt.15) era pritet të fryjë e lehtë, mesatare deri e fortë.

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LARTË** |
|---|---|---|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | S'KA RREZIK | shumë intensive | | | | | |
| **KUKËS** | S'KA RREZIK | shumë intensive | | | | | |
| **DIBËR** | S'KA RREZIK | shumë intensive | | | | | |
| **LEZHË** | S'KA RREZIK | shumë intensive | | | | | |
| **DURRËS** | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| **TIRANË** | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| **ELBASAN** | S'KA RREZIK | shumë intensive | | | | | |
| **FIER** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **BERAT** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **KORÇË** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **VLORË** | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |
| **GJIROKASTËR** | S'KA RREZIK | intensive | | | | | |

| **Buletini Nr. 348/ 2022, 14-12-2022** | **Parashikimi** nga 14-12-2022, ora 12:00 deri më 15-12-2022, ora 23:59. |
|---|---|

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 14 – 15.***

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
| | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
| | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
| | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
| | Rrëshqitje toke |